



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN KADASTËR DHE PRONË

Datë/Data/Date:	17.03.2025
Nga/Od/From:	Komisioni për monitorim të realizimit të kontratave Nerimane Kelani Sami Krasniqi Hamit Mjeku
Për/Za/To:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës Arben Berisha, Drejtor i DPUKP-së
Tema/Subjekat/Subject	Raport

Të nderuar,

Komisioni për "Monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim" i emëruar me anë të vendimit nr. 02-104-02-38575-24 të datës 17.12.2024 harton këtë:

RAPORT

Komisioni gjatë muajit Janar 2025 ka pranuar dokumentacion shtesë për investitor të tjerë që kanë marrë prona komunale me qëllim të investimit, monitorimi është bërë për 6 mujorin e dytë të vitit 2024, ku për secilin operatorë (investitor) kemi hartuar edhe procesverbal, si më poshtë:

- Vendim me nr. I-181 datë 26.07.2010 ku komuna ka aprovuar kërkesën e NPT "Dalma" për ndarjen e 50 ari tokë për vendosjen e fabrikës me elemente montimi nga metali, , në afat për 10 dhe 20 vite, Kompania sipas vendimit ka 10/20 vite afat me mundësi vazhdimi të shfrytëzimit të pronës komunale, Investitori ka ndërtuar objektin dhe bënë prodhimin e elementeve të betonit. Pala pohon se ka mungesë të rrjetit të kanalizimit, ka të punësuar 10 punëtorë, 5 nga ta nga komuna e Obiliqit.
- Kontrata me nr. 0I-100-10 datë 07.05.2010 mes të Komunës së Obiliqit (Autoritetit Kontraktues) dhe në anën tjetër Operatori ekonomik "Agro Eko" përfaqësuar nga Arsim Preniqi, me qëllim "Të ndërtimit të serave për kultivimin e perimeve edhe me qëllim zhvillimit të bizneseve të vogla prodhuese-agro biznese". Kompania sipas kontratës ka 10 vite afat për shfrytëzim të pronës. Investitori nuk ka ndërtuar seren e paraparë dhe nuk është shfrytëzues i pronës dhe po ashtu nuk është i regjistruar si shfrytëzues në të dhënat kadastrale të KK Obiliq.

3. Vendim me nr. 01-227 datë 28.09.2010 ku komuna ka aprovuar kërkesën e K.U.R "Prishtina" NJ.O.U-Obiliqi për ndërrimin e parcelës nr.670/1 për ndërtimin e Objektit të ujësjetillësit , Njësia Obiliqi, parcela e lejuar për ndërtimin e objektit është nr.00681/7 ZK Obiliqi në shfrytëzim me qera për 10 vite me mundësi vazhdimi. K.U.R "Prishtina" ka ndërtuar objektin dhe operon edhe më tutje, pohojnë se kanë paraqitur kërkesë për vazhdim afati.
4. Vendim me nr.01-138/09 datë 26.05.2019 ku komuna ka aprovuar kërkesën e qytetarit Shfaqet Bajrami nga fshati Raskovë, për ndarjen e trollit 8 ari tokë zona kadastrale Milloshevë, në të cilën parcel është ndërtuar objekt montazh për larjen e veturave ku edhe tani është duke operuar.
5. Vendimi me nr. I-260 datë 28.10.2010 ku është aprovuar kërkesa e NTP "Noti" për dhënie të tokës me koncesion në sipërfaqe prej 1 HA për ndërtimin e fabrikës së betonit fshati Bërnice, në afat prej 10/20 vite si dhe Kontrata me nr. II-74 datë 05.04.2010 mes të **Komunës së Obiliqit** (Autoritetit Kontraktues) dhe në anën tjetër Operatori ekonomik NNP "NOTI" përfaqësuar nga Xhavit Binaku, me qëllim "**Të ndërtimit të fabrikës së betonit, fabrikës për prodhimin kabëzave, autoservis për rregullim të makinave të rënda dhe vullknaizer për makina të rënda dhe objekti i administratës**". Kompania sipas kontratës ka 10/20 vite afat për shfrytëzim të pronës. Investitori operon në atë zonë dhe ka të punësuar rreth 19 punëtor, 10 nga ta janë nga komuna e Obiliqit.